

APPLICATION OF STEP BY STEP METHODOLOGY IN PRESCHOOL CHILDREN EDUCATION

Agim Bujari

Kosovo Pedagogical Institute, Republic of Kosovo, agim.bujari@gmail.com

Abstract: One of many contemporary programs which aim to affirm the need of organization of educational work, by having the child as a starting point, is the "Step by Step" program (Kulinxha, 2015).

Step-by-Step Methodology for preschool education, designated for children 3-6 years old, emphasizes the parental involvement, individualized teaching and a classroom environment that supports children's free choice. Classes are organized in activity centers in order to motivate learning by playing games, collaborative learning and learning through concrete materials. Step by Step is a program that promotes contemporary learning and the right approach to early childhood development. This program has begun in 1994 and this methodology offers opportunities for the child to be in the center. Child-centered means placing the student in an active and creative role in learning. This methodology is based on the ideas of: Piaget, Erikson, Vygotsky, Montessori, etc., who regarded the child as a biological organism (Shala, R. 2017).

The purpose of this research is to empirically find out whether the Step by Step methodology is applied in preschool children education in Kosovo preschool institutions.

Empirical results show that 79.7% of educators apply the Step by Step methodology, and the rest apply other methodologies in preschool children education. Empirical findings show that educators, who have completed 3-year bachelor studies, find it more difficult to implement the methodology. $M = 15.93$, whereas educators who have completed 4-year bachelor studies, find it less difficult to implement the methodology. $M = 41.45$, the value of $X^2 = 11.434$ (df3), whereas $p = 0.010 < 0.05$.

Keywords: education, children, step by step, methodology, age, preschool

ZBATIMI I METODOLOGJISË HAP PAS HAPI NË EDUKIMIN E FËMIJËVE TË MOSHËS PARASHKOLLORE

Agim Bujari

Instituti Pedagogjik i Kosovës, Republika e Kosovës, agim.bujari@gmail.com

Abstrakt: Një ndër programet e shumta bashkëkohore, që synon të afirmojë nevojën e organizimit të punës edukativo-arsimore, duke pasur si pikënisje fëmijën, është edhe programi "Hap pas Hapi" (Kulinxha, 2015).

Metodologjia "Hap pas Hapi" për arsimin parashkollor, i hartuar për fëmijët 3-6 vjeç, vë theksin te pjesëmarrja e familjes, mësimdhënia e individualizuar dhe një mjedis klase që mbështet zgjedhjen e lirë të fëmijëve. Klasat janë të organizuara në qendra veprimtarie, në mënyrë që të nxitet të mësuarit përmes lojës, të mësuarit në bashkëpunim, si dhe të mësuarit përmes materialeve konkrete. "Hap pas Hapi" është një program që promovon mësimin bashkëkohor dhe qasje të përshtatshme për zhvillim në fëmijërinë e hershme. Fillet e këtij programi janë që nga viti 1990 dhe kjo metodologji ofron mundësi që fëmija të vihet në qendër. Fëmija në qendër do të thotë vënia e nxënësit në pozitën e subjektit aktiv dhe kreativ në mësim. Kjo metodologji është e mbështetur në idetë e Piazhës, Eriksonit, Vigotskit, Montesorit etj., të cilët e shikonin fëmijën si një organizëm biologjik (Shala, R. 2017).

Qëllim i hulumtimit është që në mënyrë empirike të gjejmë sa zbatohet metodologjia "Hap pas Hapi" në edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore, në institucionet parashkollore në Kosovë.

Nga rezultatet empirike u gjet se 79.7 % e edukatoreve zbatojnë metodologjinë "Hap pas Hapi", ndërsa pjesa tjetër zbatojnë metodologji të tjera në edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore. Gjetjet empirike treguan se vështirësi më të mëdha në zbatimin e kësaj metodologjie kanë edukatorët, të cilat kanë kryer studimet bachelor 3-vjeçar, $M=15.93$, ndërsa edukatorët që kanë më së paku vështirësi janë edukatorët që kanë kryer studimet bachelor 4-vjeçar, $M=41.45$, vlera e $X^2=11.434$ (df3), ndërsa $p=0.010<0.05$.

Fjalët çelës: edukim, fëmijë, hap pas hapi, metodologji, moshë, parashkollore

1. HYRJE

Edukimi parashkollor paraqet nivelin e parë të arsimit parauniversitar në Kosovë, përkatësisht shkallën 0 të Standardeve Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit (ISCED), në të cilën përfshihen fëmijët deri në moshën 6-vjeçare.

Edukimi parashkollor në Kosovë organizohet në institucionet parashkollore publike (çerdhjet dhe kopshtet) dhe institucionet parashkollore private, qendrat/kopshtet me bazë në komunitet dhe klasat përgatitore, të cilat funksionojnë në kuadër të shkollave fillore (niveli parafillor). Edukimi i fëmijëve bëhet përmes metodologjive të ndryshme bashkëkohore, duke u fokusuar kryesisht në qasjet me në qendër fëmijën.

Qasjet me në qendër nxënësit vendosin një theks shumë më të fortë në rolin e nxënësit në procesin e të nxënës sesa në qasjen me në qendër mësuesin. Kur aplikohet qasja e mësuesit me në qendër nxënësit, mësuesi vendosin agjendën e të nxënës, por kanë shumë më pak kontroll të drejtpërdrejtë mbi atë dhe si mësojnë nxënësit (Gill& Kusum, 2017).

Ndër metodologjitë që aplikohet në masë të madhe në edukimin parashkollor, e që si qasje e ka nxënësin në qendër, është metodologjia “Hap pas Hapi”.

Metodologjia “Hap pas Hapi” fillet i ka rreth viteve të 90-ta e që në Kosovë, fillimisht u ofrua nga organizata të ndryshme ndërkombëtare. Kjo metodologji gjeti një përkrahje nga institucionet vendore, ku me ndihmën e organizatave të ndryshme, u organizuan trajnime e kurse për mësuesin të niveleve të ndryshme. Kjo metodologji filloi të zbatohet edhe nga edukatorët e kopshteve, e që rezultoi se ishte mjaft e përshtatshme për fëmijët e moshës parashkollore. Zbatimi i projektit edukativ me fëmijën në qendër i ashtuquajtur, programi “Hap pas Hapi” në çerdhe dhe kopshte, si projekti i parë i zhvilluar në nivelin e edukimit parashkollor në Kosovë, arriti të sjellë ndryshime në praktikën e punës me fëmijët dhe të krijojë një praktikë më fleksibile me forma të ndryshme të punës, duke synuar edukimin e fëmijëve për të qenë qytetar të një shoqërie demokratike. Pikërisht nga ky program burojnë edhe nismat e para drejt ndryshimit të praktikës së punës me fëmijët dhe hapat metodologjikë të përparuar që vlerësojnë marrëdhëniet interaktive të rritur-fëmijë dhe fëmijë-fëmijë (Shala, 2017).

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Edukimi parashkollor mbështetet në standardet e zhvillimit dhe të nxënës në fëmijërinë e hershme 0-6 vjeç, standarde të cilat mbështesin dhe nxisin zhvillimin optimal të fëmijëve. Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj periudhe të zhvillimit në vendosjen e një baze të mirë për të nxënës gjatë gjithë jetës, ekspozimi i fëmijëve ndaj proceseve elementare të të nxënës do të fokusohet në nxitjen e kërkimeve të tyre për veten, për shoqërinë, për natyrën, dijen, kulturën dhe për teknologjitë e reja (MASHT, 2016). Për edukimin e drejtë të fëmijëve në institucione parashkollore, ndër përgjegjëset kryesore janë edukatorët. Sipas Shoqatës Ndërkombëtare “Hap pas Hapi” (ISSA), edukatorët kompetentë të shekullit 21 zotërojnë shtatë zona fokusi që pasqyrojnë bindjet kryesore të ISSA-së për pedagogjinë cilësore dhe identifikojnë mënyrat për të aspiruar përsosmërinë: Ndërveprimet, Familja dhe Komuniteti, Përfshirja, Diversiteti dhe Vlerat e Demokracisë, Vlerësimi dhe Planifikimi, Strategjitë e mësimit, Mjedisi i të nxënës, Zhvillimi profesional (ISSA, 2010). Në metodologjinë “Hap pas Hapi”, prindërit paraqesin një nga shtyllat e forta në të cilat mbështetet kjo metodologji, andaj ata duhet të jenë pjesë e të gjitha proceseve që zhvillohen në institucionet parashkollore, duke siguruar një partneritet gjithëpërfshirës që ka për bazë interesat më të larta të fëmijës (MASHT, 2019).

2.1. Metodologjia “Hap pas Hapi”

Përgatitja e fëmijëve në përballimin e sfidave të së ardhmes shton detyrën kryesore të motivimit të tyre për të mësuar gjatë gjithë jetës. Me qëllim që fëmijët të përgatiten si studiues të motivuar, metodologjia “Hap pas Hapi” krijon bazë të qëndrimeve, njohurive dhe shprehive për të përballuar sfidat aktuale (Coughlin, et al., 1997) dhe ato të mëvonshme. Metodologjia “Hap pas Hapi” është ndërtuar në atë mënyrë që ta përgatisë secilin fëmijë që të jetë qytetar aktiv. Kjo metodologji mbështet parimin se fëmijët rriten dhe edukohen më mirë kur përfshihen natyrshëm në edukimin e tyre (Vadahi, 2002). Mjedisi i planifikuar me kujdes në metodologjinë “Hap pas Hapi” inkurajon fëmijët të eksplorojnë, të kenë iniciativë dhe të jenë krijues. Përgatitja e mjedisit dhe organizimi i qendrave të aktiviteteve është përgjegjësi e edukatores, andaj një kujdes i shtuar duhet t’i kushtohet përcaktimit të qendrave të aktiviteteve me hapësirën e dhomës kur dihet se jo gjithmonë mund të kemi hapësirën që na nevojitet (MASHT, 2019).

Në vitin 1994, Fondacionet e Shoqërisë së Hapur nisi programin “Hap pas Hapi”, një iniciativë për reformën e hershme të edukimit të fëmijëve (Klaus&Ghent, 2014), e cila prezantoi një qasje të përqendruar te fëmijët dhe komuniteti, si një mënyrë për të promovuar dhe zhvilluar parimet demokratike (Stasz et al., 2008). Aktiviteti kryesor i programit ishte të mbështeste zhvillimin profesional të mësuesve (mësues, ndihmës mësuesish, trajnerë mësuesish, metodicient, administratorë) dhe të siguronte burime për të zhvilluar klasa dhe praktika mësimore që do të promovonin të menduarit e hapur dhe kritik në një brez të ri të fëmijëve (Stasz et al., 2008).

“Hap pas Hapi” është një metodologji e përqendruar në moshën e fëmijërisë së hershme, në të cilën bazohet praktika të përshtatshme zhvillimore (Ronna&Lee, 2001). Programi “Hap pas Hapi” promovon mësimin bashkëkohor dhe qasje të përshtatshme për zhvillim në fëmijërinë e hershme. Kjo metodologji ofron mundësi për zhvillim profesional për edukatorët, me qëllim që të sigurojë qasje më të lehtë në metoda të reja të punës dhe në bashkëpunim me

familjet dhe me komunitetin, në mënyrë që të ofrojë informacion të ri mbi edukimin në fëmijërinë e hershme (KEEN, 2018). Kjo metodologji ka treguar sukses me fëmijë që kanë prejardhje të ndryshme kulturore (Ronna&Lee, 2001).

Kurrikula sipas programit “Hap pas Hapi” merr për bazë zhvillimin e fëmijës, fazat zhvillimore të tij dhe aftësitë e interesimet individuale të fëmijës. Një kurrikulë e tillë duhet të përmbajë aktivitete që nxisin interesimin e fëmijëve, nivelin e tyre të njohjes, si dhe pjekurinë e tyre emocionale dhe atë shoqërore (Coughlin et al. 1997).

Synimet kryesore të programit “Hap pas Hapi” janë: të krijojnë gjenerata që mësojnë gjatë gjithë jetës, të krijojnë një mjedis mësues të bazuar në respektin reciprok dhe parimet demokratike, të sigurojnë vazhdimësinë dhe praktikën zhvillimore, të sigurojnë që të gjithë fëmijët të përfshijnë aftësi akademike, artistike, etike, praktike dhe të marrin pjesë me suksese në një shoqëri demokratike.

Kjo metodologji “imponon” nevojat për krijimin e partneritetit edukator-nxënës. Familja luan rol të pazëvendësueshëm në realizimin e kësaj metodologjie. Organizimi i klasës bëhet në qendrat e aktivitetit. Planifikimi i punës bëhet duke u mbështetur në integrimin e përmbajtjeve programore, ndërsa qëllimi përfundimtar i metodologjisë “H-p-H” të punës me fëmijët e moshës 5-6 vjeç është përgatitja e fëmijës për klasën e parë. (ISSA, 2002).

2.2. Metodologjia “Hap pas Hapi” përkrah:

- ✚ Individualizimin në mësimdhënie, për të arritur potencialin për zhvillim të plotë të çdo individi në aspektin psiko-social, fizik dhe shoqëror, duke respektuar mënyrën e të nxënës, temperamentin dhe interesimet e fëmijës. Të mësuarit efikas mbështetet në aftësinë për të individualizuar, që nënkupton qasjen e organizmit të punës, në bazë të specifikave të veçanta të çdo fëmije (Kulinxha, 2015);
- ✚ Të nxënës aktiv dhe bashkëveprues (puna në grupe dhe çifte);
- ✚ Zhvillimin e pavarësisht të fëmijës, ndjenjën e përgjegjësisë, respektit ndaj vetvetes dhe vetëbesimit;
- ✚ Planifikimin tematik për punë edukative;
- ✚ Motivacionin dhe frymëzimin e ambientit ku mësohet, duke përfshirë këtu edhe materialet dhe mjetet për mësim;
- ✚ Bashkëpunimi me anëtarët e familjes dhe rrethin (komunitetin);
- ✚ Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në punë edukative.

2.3. Baza teorike e metodologjisë “Hap pas Hapi”

“Hap pas Hapi” është një program i përqendruar te nxënësit, i cili promovon qasje bashkëkohore të mësimdhënies të përshtatshme për zhvillimin e hershëm të fëmijërisë (Haziri-Zylfiu, 2016).

Ky program u ndërtua mbi bazat teorike të punës së Rusosë, Pestalocit, Frebelit, Piazhësë, Bruner, Erikson, Djuj, Kamensky, Vigotski dhe të tjerët, dhe ka krijuar ndryshime pozitive në disa nivele, duke përfshirë: ndërveprimet e mësimdhënësve me fëmijët në klasë, zhvillimi profesional i mësimdhënësve, marrëdhëniet me familjet dhe komunitetin, etj. Në të njëjtën kohë, roli i edukatorit është vendimtar; siç theksohet në teorinë e zhvillimit të Lev Vigotski, mësimdhënësit janë përgjegjës për ritmin dhe rrjedhën e zhvillimit të fëmijëve të tyre (ISSA, 2010).

Piazhë mendonte se fëmijët rriten duke kaluar nëpër faza të ndryshme. Faza e parë është periudha sensomotorike, e cila shfaqet deri në moshën 2-vjeçare. Faza e dytë është faza e veprimeve konkrete, e cila shfaqet në mes të moshës 2-12-vjeçare. Faza e tretë është faza formale e veprimeve dhe fillon diku në adoleshencën e hershme.

Maria Montessori mendonte se mjedisi në të cilin fëmijët do t'i shfrytëzojnë njohuritë e reja dhe të sjellin përvojat e tyre jetësore është shumë i rëndësishëm për edukimin e vlerave të tyre.

Eriksoni zhvillimin e shëndetshëm e shikon si karakteristikë e moshave të veçanta. Nga lindja deri në moshën 1-vjeçare, rritja karakterizohet nga zhvillimi i besimit, nga moshë 1 deri në moshën 3-vjeçare, fokusi është zhvillimi i pavarësisht dhe nga moshë 3 deri 6 vjeçare, individi i shëndetshëm fiton një ndjenjë vetëveprimi (Hansen, et al., 1997).

Veprimtaria kryesore për fëmijët në këto institucione është loja, përmes së cilës edhe ndodh zhvillimi i tyre, përgatitja e tyre për jetën dhe realizimi i qëllimit të edukimit. Ajo shfaqet apo manifestohet në formë nga më të ndryshmet, si: loja me objekte, loja spontane e pastrukturuar, loja me një fëmijë tjetër, loja dramatike, loja me materiale skenike, loja e strukturuar, loja e lirë etj. (Coughlin et al., 1997).

2.4. Planifikimi i punës sipas metodologjisë “Hap pas Hapi”

Puna sipas metodologjisë “Hap pas Hapi” mund të planifikohet për afat të gjatë dhe afat të shkurtër. Në kuadër të planifikimit afatgjatë hyjnë planifikimi mujor dhe ai vjetor. Gjatë planifikimit mujor, planifikohen tema interesante, që ngjallin kureshtje dhe tingëllojnë bukur për fëmijët. Duhet të planifikohen veprime ditore për çdo temë, të hartohen objektiva tematike që kanë lidhje me të gjitha fushat e zhvillimit dhe të planifikohen veprimtaritë e çdo qendre dhe teknikat e punës që do të përdoren (Selmani&Zisi, 2006).

Planifikimi i shkurtër përfshin planifikimin javor dhe ditor. Planifikimi javor është i detajuar në ditë dhe sipas qendrave të veprimtarive. Planifikimi ditor është i detajuar në orë dhe minuta. Në planifikimin javor, duhet të

planifikohen forma, metoda e teknika të larmishme si dhe veprimtari specifike për punë në grup të madh. Gjatë planifikimit ditor duhet të pasur parasysh që të përcaktohet koha duke u mbështetur në regjimin ditor, të integrojnë veprimtaritë e qendrave me temën ditore (Selmani&Zisi, 2006).

2.5. Parimet e metodologjisë “Hap pas Hapi”

Metodologjia “Hap pas Hapi” ngërthen në vete tri parime kryesore:

Konstruktivizmi - Mbështetësit e konstruktivizmit besojnë se mësimi shfaqet derisa fëmijët përpiqen të kuptojnë botën që i rrethon. Kur ndeshim të dhëna apo përjetime mospërrputhëse, ne ose interpretojmë atë që shohim se përputhet me rregullat aktuale për shpjegimin dhe rregullimin e botës sonë ose nxjerrim rregulla të reja që shpjegojnë më mirë atë që perceptojmë se po ndodh (Brooks&Brooks, 1993). Mjediset e të mësuarit konstruktivist sigurojnë përfaqësime të shumta të realitetit si një gamë të gjerë përfaqësimesh, duke shmangur thjeshtësimin e tepërt dhe duke reflektuar kompleksitetin e botës reale (ISSA, 2015).

Praktika e përshtatshme zhvillimore - Të gjithë fëmijët avancojnë nëpërmjet fazave të zakonshme zhvillimore, por në të njëjtën kohë çdo fëmijë është një qenie unike e individuale. Edukatorët duhet të njohin rritjen dhe zhvillimin tipik të fëmijës, me qëllim që të sigurojnë një renditje realiste të materialeve dhe aktiviteteve të mësimi. Ata duhet të vëzhgojnë, të vënë re dhe të dëgjojnë për ndryshimet midis shprehjeve, shkathtësive dhe interesave të veçanta të fëmijëve të së njëjtës moshë (Seefeldt&Bredecamp, 1993 in Coughlin, 1997).

Edukimi progresiv - Sipas Xhon Djuit, që është përfaqësues i edukimit progresiv, edukimi është përgatitje për të ardhmen. Sipas Djuit, për të përgatitur fëmijën për të ardhmen do të thotë t'i japësh atij aftësinë e zotërimit të vetvetes, do të thotë ta aftësosh që ai t'i arrijë një përdorim të plotë dhe të gatshëm të të gjithë kapaciteteve të tij, që syri, veshi dhe dora të jenë gati ndaj kësaj aftësie zotëruese, që gjykimi të jetë i aftë të perceptojë kushtet në të cilat duhet të punojë (Dewey, 2003). Sipas Djuit, anëtarët psikologjike dhe shoqërore janë të lidhura organikisht dhe se edukimi nuk duhet të shihet si kompromis, por ndërveprim.

2.6. Roli i edukatores në zbatimin e metodologjisë “Hap pas Hapi”

Janë edukatorët/et ata/ato të cilët i japin jetë secilës metodologji të edukimit parashkollor, përfshirë këtu edhe metodologjinë “Hap pas Hapi”. Ata/ato janë përgjegjëse për të transformuar mjedisin ku fëmijët qëndrojnë për shkak të mirë funksionimit dhe përmirësimit të cilësisë së ndërveprimit me mjedisin apo edhe me personat e rritur përreth. Edukatori/ja ofron siguri për fëmijën, inkurajon dhe nxit atë drejt lojës së pavarur, duke i lehtësuar procesin e të nxënës përmes krijimit të mjedisit për vetaktivitet të fëmijës. Sipas Jakman (2012), është përgjegjësi e edukatoreve që të ndihmojnë fëmijët që të zhvillojnë lojën e tyre. Loja duhet të jetë pjesë integrale e të gjithë procesit edukativ që zhvillohet në institucionet parashkollore. Edukatori/ja planifikon zhvillimin e aktiviteteve mbi bazë të temës javore ose mujore. Duke integruar kështu punën me tërë grupin, punë me grupe të vogla dhe punën individuale të fëmijës. Vëzhgimi është një tjetër karakteristikë e metodologjisë “Hap pas Hapi”, ku edukatori/ja studion dhe analizon veprimet, sjelljet, fjalorin, etj. të fëmijës për t'i ofruar ndihmën e nevojshme në varësi të nevojave që ai/ajo ka. Rutina ditore mundëson fleksibilitet në shtrirjen e lojërave, aktiviteteve të cilat i zhvillon me fëmijët e tjerë të grupit edukativ nëpër qendrat e ndryshme të aktivitetit. Edukatorët sipas “Hap pas Hapi” planifikojnë dhe mbështesin fëmijët drejt fitimit të shkathtësive për jetë (MASHT, 2019).

3. METODOLOGJIA DHE METODAT

3.1. Qëllimi i studimit

Qëllim i hulumtimit është që në mënyrë empirike të gjejmë se sa zbatohet metodologjia “Hap pas Hapi” në edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore, në institucionet parashkollore në Kosovë.

3.2. Pyetjet kërkimore

1. Cila është ndërlidhja në mes të arsimimit të edukatoreve dhe zbatimit të metodologjisë “Hap pas Hapi”?
2. A ka dallime në mes të edukatoreve me përvojë të ndryshme dhe bashkëpunimit me prindërit e fëmijëve?
3. Cili është dallimi në mes të përvojës së edukatoreve dhe punës që fëmijët të shprehin lirshëm dhe të jenë krijues?

3.3. Pjesëmarrësit

Grupi përfaqësues përbëhet nga 74 edukatore që punojnë në institucione parashkollore. Nga 74 edukatore, 31 ose 41.9 % prej tyre punojnë në kopshte publike, 1 ose 1.4 % në Qendër me bazë në komunitet, ndërsa 42 ose 56.8% punojnë në klasë përgatitore në kuadër të shkollës fillore. 15 ose 20.3 % e edukatoreve, janë nga komuna e Gjiçanit, 5 ose 6.8 %, janë nga komuna e Lipjanit, 15 ose 20.3 % e tyre janë nga komuna e Kaçanikut, 5 ose 6.8%, janë nga Hani i Elezit, 24 ose 32.4 %, janë nga komuna e Istogut dhe 10 ose 13.5 %, janë nga komuna e Dragashit. Sa i përket moshës, 9 ose 12.2 % janë të moshës deri 30 vjet, 28 ose 37.8 % janë të moshës 31-40-vjeçare, 18 ose 24.3 % të moshës 41-50-vjeçare, 17 ose 23 % të moshës 51-60-vjeçare dhe 2 ose 2.7 % janë të moshës mbi 60-vjeçare. Lidhur me përgatitjen arsimore, 7 ose 9.5 %, kanë të kryer bachelor 3-vjeçar, 56 ose 75.7%, kanë të kryer bachelor 4-vjeçar, 7 ose 9.5 %, kanë të kryer master, 4 ose 5.4 % e tyre, kanë të kryer nivel tjetër të shkollimit (pa specifikuar nivelin).

Prej këtyre edukatoreve, 63 ose 85.1 %, kanë kryer Edukim Parafillor, 5 ose 6.8 % kanë përfunduar studimet në Degën e Pedagogjisë, 2 ose 2.7 %, kanë kryer drejtimin fillor, 4 ose 5.4 %, kanë kryer drejtim tjetër, pa specifikuar. Rreth 14 ose 18.9 % e edukatoreve kanë përvijë deri 5 vjet, 30 ose 40.5 % e tyre kanë përvijë 6-15 vjet, 20 ose 27 % kanë përvijë 16-25 vjet, 8 ose 10.8 % kanë përvijë 26-35 vjet dhe 2 ose 2.7 % e edukatoreve kanë përvijë mbi 35 vjet. Rreth 69 ose 93.2 % e edukatoreve janë shprehur se kanë njohuri për metodologjinë “Hap pas Hapi”, ndërsa 5 ose 6.8 % nuk kanë njohuri për këtë metodologji. Pas fillimit të punës, 43 ose 58.1 % prej tyre kanë kryer trajnime për metodologjinë “Hap pas Hapi”, ndërsa 31 ose 41.9 %, nuk kanë kryer asnjë trajnim për zbatimin e kësaj metodologjie. Rreth 3 ose 4.1 % e edukatoreve janë shprehur se kushtet në kopsht janë shumë të dobëta, 11 ose 14.9 % janë shprehur se kushtet janë të dobëta, 21 ose 28.4 % janë shprehur se kushtet janë deri diku të mira, 26 ose 35.1 % janë shprehur se kushtet janë të mira dhe 13 ose 17.6 % e edukatoreve janë shprehur se kushtet në kopsht janë shumë të mira. Vetëm 1 ose 1.4 % e edukatoreve e zbatojnë metodologjinë “Majeutika”, 5 ose 63.8 % e tyre e zbatojnë metodologjinë “Montessori”, 59 ose 79.7 % e edukatoreve e zbatojnë metodologjinë “Hap pas Hapi” dhe 9 ose 12.2 % e tyre zbatojnë metodologji të tjera.

3.4. Instrumentet e hulumtimit

Instrumenti i hulumtimit është i përgatitur enkas për nevojat e studimit dhe përbëhet nga 2 pjesë. Në pjesën e parë janë paraqitur të dhënat demografike të edukatoreve, ndërsa në pjesën e dytë janë parashtruar 23 pyetje të shkallës Likert, që lidhen me zbatimin e metodologjisë “Hap pas Hapi” nga ana e edukatoreve. Shkallët ishin të shkallëzuara në këtë formë: 1. Aspak nuk pajtohem, 2. Nuk pajtohem, 3. Deri diku pajtohem, 4. Pajtohem 5. Pajtohem plotësisht.

3.4.1. Besueshmëria e instrumentit

Për matjen e besueshmërisë së instrumentit për zbatimin e metodologjisë “Hap pas Hapi”, u përdoren 2 (dy) modele: modeli Alpha Chronach’s dhe modeli Parallel.

Në bazë të rezultateve, në modelin Alpha Chronach’s vërehet se vlera e parashikuar e besueshmërisë së instrumentit është 0.909, ndërsa vlera e besueshmërisë është 0.888, ndërsa sipas modelit Parallel, vlera e parashikuar është 0.891, ndërsa vlera e realizuar 0.888. Këto dy vlera janë të njëjta me njëra-tjetrën dhe tregojnë që matësi është me besueshmëri të lartë.

Në bazë të këtyre rezultateve, mund të themi se besueshmëria e instrumentit të përdorur është e lartë dhe instrumenti i hulumtimit i plotëson kushtet për përdorim.

3.5. Metodat e analizës së të dhënave statistikore

Të dhënat nga hulumtimi sasior, janë analizuar përmes paketës statistikore për shkencat sociale (SPSS). Për të testuar qëndrueshmërinë e brendshme të instrumentit, është përdorur Alpha Cronbach dhe Parallel, duke marrë vlerën mbi 0.7 si vlerë që dëshmon nëse pyetësi ka ose jo qëndrueshmëri të brendshme. Për vlerësimin e rezultateve të të gjitha testeve statistikore, është vendosur niveli i domethënies statistikore 0.05.

Për të bërë krahasimin e mesatareve në bazë të përvijës së edukatoreve dhe bashkëpunimit me prindërit e fëmijëve, është përdorur Testi One Way ANOVA. Testi Kruskal Wallis është përdorur për të testuar ndërlidhjen në mes të shkollimit të edukatoreve dhe zbatimit të metodologjisë “Hap pas Hapi”, si dhe përvijës së edukatoreve dhe punës që fëmijët të shprehen lirshëm dhe të jenë krijues.

4. REZULTATET

4.1. Rezultatet përshkruese

Nga rezultatet e përgjithshme u gjet se 3.9 % e edukatoreve nuk angazhohen mjaftueshëm në zbatimin e metodologjisë “Hap pas Hapi”, 10.4 % e tyre deri diku angazhohen, ndërsa 85.7 % e edukatoreve angazhohen mjaftueshëm për zbatimin e metodologjisë “Hap pas Hapi”. Duke u bazuar në këto rezultate, del se mesatarja e përgjithshme është shumë e lartë, $M=4.36$.

4.2. Rezultatet lidhur me hipotezat

Hipoteza 1: Ka dallime statistikisht të rëndësishme në mes të edukatoreve me arsimim të ndryshëm në zbatimin e metodologjisë “Hap pas Hapi”

Testimi i hipotezës u bë përmes testit joparametrik Kruskal Wallis Test.

Rezultatet empirike treguan se vështirësi më të mëdha në zbatimin e metodologjisë “Hap pas Hapi” kanë edukatorët të cilat kanë kryer studimet bachelor 3-vjeçar, $M=15.93$, ndërsa edukatorët që kanë më së paku vështirësi janë edukatorët që kanë kryer studimet bachelor 4-vjeçar, $M=41.45$, vlera e $X^2=11.434$ (df3), ndërsa $p=0.010<0.05$. Rezultatet empirike tregojnë për një dallim statistikisht të rëndësishëm në zbatimin e kësaj metodologjie. Nga rezultatet empirike mund të konstatohet se është mbështetur hipoteza alternative.

Hipoteza 2: Ka dallime statistikisht të rëndësishme në mes të përvijës së edukatoreve dhe bashkëpunimit me prindërit e fëmijëve

Testimi i hipotezës është bërë përmes testit parametrik ANOVA, njëdrejtimëshe. Rezultatet empirike treguan se ka dallime statistikisht të rëndësishme në bazë të përvijës së edukatoreve dhe bashkëpunimit me prindërit e fëmijëve.

Mesataren më të lartë në bashkëpunimin me prindërit e fëmijëve e kanë edukatorët me përvojë 26-35-vjeçare, $M=5$, pastaj janë edukatorët që kanë përvojë 16-25-vjeçare, $M=4.8$, edukatorët me përvojë deri 5-vjeçare, $M=4.64$, pastaj edukatorët me përvojë 6-15-vjeçare, $M=4.5$, ndërsa bashkëpunimin më të ulët me prindërit e fëmijëve e kanë edukatorët që kanë përvojë mbi 35-vjeçare, $M=3$, vlara e $F=5.404$, ndërsa $p=0.001<0.05$. Nga ky rezultat, mund të konstatohet se është mbështetur hipoteza alternative.

Hipoteza 3: Ka dallime statistikisht të rëndësishme në mes të edukatoreve me përvojë të ndryshme dhe punës që fëmijët të shprehen lirshëm dhe të jenë krijues

Testimi i hipotezës është bërë përmes testit joparametrik Kruskal Wallis.

Rezultatet treguan se mesataren më të lartë e kanë edukatorët që kanë përvojë 26-35-vjeçare, $M=49$, ndërsa mesataren më të ulët e kanë edukatorët që janë në prag të pensionimit, e që kanë mbi 35 vjet përvojë, $M=9.5$, vlara e $X^2=12.528$ (df 4), $p=0.014<0.05$. Këto rezultate treguan se përvoja ka një rëndësi, mirëpo përvoja shumë e gjatë krijon edhe lodhje dhe me këtë rast janë dy kategori me përvojë të përafërt, njëra ka mesataren më të lartë, ndërsa tjetra më të ulët. Rezultatet treguan se është mbështetur hipoteza alternative, pasi që ekzistojnë dallime statistikisht të rëndësishme në mes të rezultateve të edukatoreve në bazë të përvojës së tyre.

5. PËRFUNDIME

Në bazë të rezultateve empirike, mund të vërehen rezultatet, ku shumica e edukatoreve angazhohen për zbatimin e metodologjisë “Hap pas Hapi”. Nga rezultatet e përgjithshme u gjet se vetëm 3.9 % e edukatoreve nuk angazhohen mjaftueshëm në zbatimin e metodologjisë “Hap pas Hapi”, 10.4 % e tyre deri diku angazhohen, ndërsa 85.7 % e edukatoreve angazhohen mjaftueshëm për zbatimin e kësaj metodologjie. Duke u bazuar në këto rezultate, del se mesatarja e përgjithshme është shumë e lartë, $M=4.36$. Nga këto rezultate, nuk mund të presim dallime të mëdha në mes të rezultateve të edukatoreve në bazë të karakteristikave individuale.

Nga rezultatet empirike, nuk u gjet korrelacion i lartë e as korrelacion shumë i lartë në mes të variablave të pavarura dhe variablave të varura, por u gjetën vetëm disa ndërlidhje të nivelit të lartë në mes të variablave të varura, me rëndësi statistikore.

Nga krahasimi i rezultateve, u gjetën disa dallime statistikisht të rëndësishme në bazë të karakteristikave të edukatoreve. Rezultatet empirike treguan se ka dallime statistikore në mes të edukatoreve në bazë të shkollimit të tyre. Këto rezultate treguan se edukatorët që kanë kryer studimet bachelor 4-vjeçar më me lehtësi e zbatojnë metodologjinë “Hap pas Hapi” sesa edukatorët që kanë kryer nivele të tjera të shkollimit. Nëse i referohemi nivelit të shkollimit, edukatorët me master do të duhej të mos kishin vështirësi në zbatimin e metodologjisë “Hap pas Hapi”.

Dallime u gjetën në mes të edukatoreve me përvojë të ndryshme dhe bashkëpunimit me prindërit e fëmijëve. Rezultatet empirike treguan se edukatorët me përvojë 26-35-vjeçare bashkëpunojnë më shumë me prindërit e fëmijëve, ndërsa bashkëpunimin më të ulët e kanë edukatorët me përvojë mbi 35-vjeçare. Këto rezultate e mbështesin teorinë e Tolbert dhe Moen, të cilët theksojnë se punonjësit më të vjetër në moshë, për më tepër ata që janë në fund të karrierës, janë më pak të motivuar të përmirësojnë rezultatet në punë (Tolbert&Moen, 1998).

Nga rezultatet e ndërlidhjes së moshës së edukatoreve është edhe ndërlidhja e përvojës së edukatoreve. Edukatorët me përvojë 26-35-vjeçare, që është në përafëri me moshën 51-60-vjeçare, angazhohen më së shumti që fëmijët të shprehen lirshëm dhe të jenë krijues, ndërsa mesataren më të ulët e kanë edukatorët që kanë mbi 35 vjet përvojë, e që është përafërsisht me moshën mbi 60-vjeçare. Nga rezultatet e përgjithshme u gjet se nuk ka dallime shumë të mëdha, në mes të edukatoreve, sa i përket zbatimit të metodologjisë “Hap pas Hapi”.

Duke u bazuar në atë se metodologjia “Hap pas Hapi” krijon bazë të qëndrimeve, njohurive dhe shprehive, ndihmon në përgatitjen e fëmijëve në përballimin e sfidave të së tashmes dhe të së ardhmes, edukatoreve u rekomandohet që këtë metodologji ta zbatojnë gjatë punës me fëmijët e moshës parashkollore.

LITERATURA

Brooks, G. J., & Brooks, M. G. (1993). The Case for Constructivist Classrooms (revised edition),

<http://www.ascd.org/readingroom/books/brooks99book.html>

Coughlin, et al. (1997). Hap pas Hapi: Një program për fëmijët dhe familjet: Krijimi i klasave me fëmijët në epiqendrë: fëmijët 3-5 vjeçar. Washington D.C.: Organizata Ndërkombëtare për Burimet e Fëmijëve.

Dewey, J. (2003). Shkolla dhe shoqëria (The school and Society). Tiranë, ISBN 99927-924-4-2, pp 13-14.

Early Childhood Program-Open Society Foundations, www.opensocietyfoundations.org > programs > early-c.

Edukimi parashkollor në Kosovë. (2018). KEEN, Prishtinë.

Gashi-Alliu, M. (2014). Gjendja e përgjithshme në edukim parashkollor 0-6 vjeç, në institucionet parashkollore publike në Kosovë (Raport hulumtimi), IPK, Prishtinë, pp 30-31.

Gill, Kr. & Kusum, A. (2017). Teaching approaches, methods and strategy, Scholarly Research Journal for

- Interdisciplinary Studies, Online ISSN 2278-8808, SJIF 2016=6.17, www.srjis.com UGC Approved Sr. No.45269, VOL- 4/36 10.21922/srjis.v4i36.10014, pp 6692-6697
- Hansen, C. P. et al. (1997). Krijimi i klasave me fëmijë në epiqendër: Fëmijët 3-5 vjeç, New York: Organizata Ndërkombëtare e Burimeve të Fëmijëve.
- Haziri-Z. H. (2016), Step by step, KEC, Prishtinë.
- International Step by Step Association. (2004). Step by Step mentoring guide for quality improvement: A master teacher trainer handbook. Budapest: ISSA.
- International Step by Step Association. (2010). Competent Educators of the 21st Century. ISSA's Principles of Quality Pedagogy. Budapest: ISSA, <http://www.issa.nl/content/quality-resourcepack>
- Jackman, H. L. (2012). Early Education Curriculum: A child's Connection to the World (5th ed.). Belmont, CA: Wadsworth, Cengage Learning.
- Klaus, S., & Ghent, L. (2014). First Steps: A Brief History of the Step by Step Program, [www.opensocietyfoundations.org › voices › first-steps](http://www.opensocietyfoundations.org/voices/first-steps).
- Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (e rishikuar). (2016). MASHT, Prishtinë, pp 25-26.
- Kulinxha, G. (2015). Komunikimi ndërpersonal në fëmijërinë e hershme sipas programit me fëmijën në qendër, 'Libri shkollor', Prishtinë, f. 116-124.
- Kurrikula bërthamë për edukimin në fëmijërinë e hershme 0-5 vjeç. (2019). MASHT, Prishtinë.
- Ligji për edukimin parashkollor Nr. 02/L-52. (2006). Kuvendi i Kosovës, Prishtinë.
- Roads to Quality Strengthening Professionalism in Early Childhood Education and Care Systems. (2015). ISSA.
- Rona, S., & Lee, L. E. (2001). School Success for Roma Children: Step by Step Special Schools Initiative, Interim report, New York: Open Society Institute.
- Selmani, L., & Zisi, A. (2006). Konceptimi dhe organizmi i veprimtarisë mësimore-edukative në arsimin parashkollor, "Geer", Tiranë.
- Stasz, C., & Vuollo, M. (2005). "Evaluating Step by Step: Current Status and Future Directions," Santa Monica, Calif.: unpublished RAND research.
- Stasz, C., Krop, C., Rastegar, A., & Vuollo, M. (2008). The Step by Step Early Childhood Education Program (Assessment of Reach and Sustainability). RAND URL: <http://www.rand.org>
- Shala, R. (2017). Alternativat e metodologjive të edukimit parashkollor dhe aplikimi i tyre në Kosovë, punim i doktoratës, Tiranë.
- Step by Step Program and Teacher Standards. (2002). Budapest: International Step by Step Association.
- Tolbert, P.S., & Moen, P. (1998). Men's and women's definitions of 'good' jobs: Similarities and differences by age and across time. Work and Occupations.
- Vadahi, F. (2002). Pedagogjia parashkollore, "Camaj-Pipa", Shkodër.